

BANKA E SHQIPËRISË

B U L E T I N I  
Z Y R T A R

---

vëllimi 26 numër 6 gusht 2024

Data e botimit: 12.08.2024



P Ë R M B A J T J A

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2680, datë 20.6.2024 "Për miratimin e disa shtesave dhe ndryshimeve në rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave të siguruar"	5
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2852, datë 28.6.2024 "Për caktimin e shtesës kundërciklike të kapitalit"	23
3. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5024, datë 17.7.2024 "Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare dhe marrjen e masave mbikëqyrëse për Shoqërinë e Kursim-Kreditit "Rrushkull One"	24
4. Vendim i Departamentit të Mbikëqyrjes të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5416, datë 2.8.2024 "Për pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare të shoqërisë së kursim kreditit "Perlat" dhe përfundimin e procesit të bashkimit me përthithje me shoqërinë e kursim-kreditit "Rrushkull One"	28
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 40, datë 7.8.2024 "Për miratimin e raportit tremujor të politikës monetare"	30
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 41, datë 7.8.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"	31
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 42, datë 7.8.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka"	33
8. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 43, datë 7.8.2024 "Për miratimin e rregullore "Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve"	38
9. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 1, janar 2024	54
10. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 2, shkurt 2024	54
11. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 3, prill 2024	55
12. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 4, qershor 2024	55
13. Treguesi i lëndës për Buletinin Zyrtar, vëllimi 26, numër 5, korrik 2024	56





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**GUVERNATORI**

Nr. 2680 prot.

Tiranë, më 20.6.2024

**VENDIM**  
Nr 2680, datë 20.6.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E DISA SHITESAVE DHE NDRYSHIMEVE**  
**NË RREGULLOREN NR. 3762, DATË 18.7.2016**  
**“PËR KOMPENSIMIN E DEPOZITAVE TË SIGURUARA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 53, pika 5, shkronja “b”, të ligjit nr.53/2014, datë 22.5.2014 “Për sigurimin e depozitave”, i ndryshuar; të nenit 53, pika 4 të ligjit nr.8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe bazuar në propozimin e Këshillit Drejtues të Agjencisë së Sigurimit të Depozitave me vendimin nr.15 datë 20.5.2024;

VENDOSI:

1. Në rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për kompensimin e depozitave të siguruara”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi, bëhen shtesat dhe ndryshimet e mëposhtme:

1. Në nenin 4, pika 2, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. shkronja “ç” ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

*“ç) Paraqitja unike e depozituesve “Single Customer View” janë të dhënat e konsoliduara për identifikimin e çdo depozituesi në mënyrë unike në sistemin informatik të subjektit anëtar të skemës, nëpërmjet të dhënave të tij identifikuese, ku përcaktohen saktë depozitat e sigurueshme, si dhe shuma e kompensimit që përfiton ky depozitues.”*

b. shkronja "d" ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

*"d) Listëpagesa është dokumenti i dorëzuar nga likuidatori që përmban paraqitjen unike të depozituesve që përfitojnë kompensim si dhe shumat përkatëse për kompensim, dhe që pas kontrollit nga Agjencia, i dërgohet bankës agjente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit."*

2. Në nenin 6, pas pikës 3, shtohet pika 4 me përmbajtjen e mëposhtme:

*"4. Agjencia, bankat agjente dhe likuidatori përdorin SIRK për kryerjen e procesit të kompensimit nëpërmjet përdoruesve të autorizuar nga Agjencia për këtë qëllim, në përputhje me dispozitat e kësaj rregulloreje dhe aktet e miratuara nga Agjencia."*

3. Në nenin 10, shkronja "c" shfuqizohet.

4. Në nenin 13, pika 3 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

*"3. Drejtori i Përgjithshëm, me marrjen e autorizimit nga Këshilli Drejtues, organizon punën e strukturave të Agjencisë për zbatimin e masave vijuese për përgatitjen paraprake për kompensim, por pa u kufizuar, për:*

- a) verifikimin e të dhënave për depozitat dhe depozituesit në subjektin anëtar të skemës;*
- b) raportimin në SIRK nga subjekti anëtar i skemës, për paraqitjen unike të depozituesve "Single Customer View", sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë;*
- c) propozimin për rishikimin e strategjisë për sigurimin e mjeteve likuide dhe fondeve shtesë të nevojshme sipas subjektit përkatës në likuidim të detyruar, me synim optimizimin e kostove dhe respektimin e afateve ligjore të kompensimit;*
- ç) kryerjen e analizës për kostot e procesit të kompensimit si dhe të mënyrave të kryerjes së tij në zbatim të nenit 14, pika 4, të kësaj rregulloreje;*
- d) propozimin për rishikimin e strategjisë për informimin e publikut;*
- dh) vlerësimin e përmbushjes së kriterëve të përgjithshme dhe teknike nga bankat agjente, dhe marrjen e ofertave ekonomike për caktimin e bankës agjente;*
- e) marrjen e ofertave ekonomike nga subjektet mbështetëse;*
- ë) analizimin e mjaftueshmërisë së burimeve njerëzore dhe marrjen e masave për plotësimin dhe trajnimin e tyre;*

- f) bashkëpunimin me autoritetin mbikëqyrës dhe Ministrinë e Financave për zbatimin e procesit të kompensimit;
- g) propozimin për rishikimin e kuadrit rregullativ dhe rishikimin e akteve të brendshme, në rast se konsiderohet e nevojshme.”

5. Neni 14 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Me marrjen e njoftimit me shkrim nga Autoriteti Mbikëqyrës për vendosjen e subjektit në likuidim të detyruar, Këshilli Drejtues i Agjencisë miraton aktet e brendshme për kompensimin e depozitave, sipas propozimit të Drejtorit të Përgjithshëm, në veçanti për:

- a) përzgjedhjen e bankës agjente dhe të mënyrës së kryerjes së pagesave të kompensimit;
- b) miratimin e buxhetit për kompensim;
- c) miratimin e strategjisë për sigurimin e mjeteve likuide dhe fondeve shtesë të nevojshme sipas subjektit përkatës në likuidim të detyruar;
- ç) miratimin e strategjisë për informimin e publikut.

2. Drejtori i Përgjithshëm, organizon punën e strukturave të Agjencisë për procesin e kompensimit.

3. Agjencia brenda 14 ditësh pune nga marrja e njoftimit sipas pikës 1 të këtij neni, fillon kryerjen e pagesave të kompensimit të depozitave, nëpërmjet bankës agjente ose në ambientet e subjektit në likuidim të detyruar në bashkëpunim me likuidatorin, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit.

4. Për depozituesit tregtarë dhe shoqëri tregtare, pagesa e shumës së kompensimit kryhet nëpërmjet transfertës bankare. Për depozituesit individë, pagesa mund të kryhet edhe me para në dorë (CASH).”

6. Neni 15 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

“1. Likuidatori dërgon në Agjenci listëpagesën me paraqitjen unike të depozituesve “Single Customer View” duke respektuar afatin e përcaktuar në nenin 39, pika 6, të ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar. Dërgimi i listëpagesës në Agjenci kryhet nëpërmjet ngarkimit të të dhënave në SIRK sipas formatit standard të skedarëve të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë.

2. Listëpagesa, sipas pikës 1 të këtij neni, përmban vlerën neto të depozitave që kompensohen deri në nivelin maksimal të mbulimit, pasi janë zbritur të gjitha detyrimet sipas ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 “Për sigurimin e depozitave”, të ndryshuar, përfshirë ato tatimore të pagueshme në përputhje me legjislacionin në fuqi.

3. Ngarkimi i listëpagesës zyrtare në SIRK shoqërohet me dërgimin e shkresës sipas formatit të përcaktuar në aneksin 2 të kësaj rregulloreje, jo më vonë se 5 ditë nga vendosja e subjektit në likuidim të detyruar. Kjo shkresë nënshkruhet nga likuidatori dhe personat përgjegjës të ngarkuar për hartimin e listëpagesës.
  4. Agjencia kontrollon të dhënat e listëpagesës të ngarkuara në SIRK, sipas akteve të miratuara prej saj për këtë qëllim. Të dhënat e listëpagesës, që kontrollohen nga Agjencia, klasifikohen në tre grupe:
    - a) Të dhëna tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë;
    - b) Të dhëna pjesërisht të përputhshme dhe të dyshuara;
    - c) Të dhëna të pasakta dhe të bllokuara.
  5. Të dhënat e vlerësuara si tërësisht të përputhshme dhe të gatshme për pagesë, miratohen nga strukturat përkatëse të Agjencisë, sipas akteve të miratuara në zbatim të pikës 4 të këtij neni, dhe përfshihen në një listëpagesë, të konsoliduar për çdo depozitues.
  6. Listëpagesa e saktë dhe e konsoliduar për kompensimin e depozituesve të siguruar, aksesohet në SIRK nga përdoruesit e autorizuar të bankës agjente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit. Agjencia i dërgon bankës agjente ose subjektit në likuidim të detyruar, në varësi të mënyrës së përzgjedhur për kryerjen e procesit të kompensimit, informacionin e konsoliduar të listëpagesës me shkresë zyrtare.
  7. Pjesa e mbetur e të dhënave i kthehen likuidatorit nëpërmjet SIRK për saktësime përkatëse.
  8. Likuidatori korrigjon të dhënat e pasakta, të paplota, të rreme apo të falsifikuara dhe i raporton ato në të njëjtën mënyrë sipas përcaktimeve të këtij neni dhe afatit të përcaktuar nga Agjencia, duke i shoqëruar edhe me shkresë zyrtare.”
7. Neni 16 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:
- “1. Likuidatori bashkëpunon me Agjencinë, në veçanti por pa u kufizuar në lidhje me:
    - a) Përgatitjen dhe dërgimin e listëpagesës duke raportuar në SIRK, sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje;
    - b) shqyrtimin e ankesave të depozituesve në përputhje me nenin 20 të kësaj rregulloreje;
    - c) trajnimin e punonjësve të subjektit në likuidim të detyruar për informimin e depozituesve lidhur me kompensimin e depozitave;
    - d) mbrojtjen e interesave të Agjencisë për rimarrjen e



shpenzimeve dhe shumave të paguara prej saj nga procesi i likuidimit.

2. Likuidatori i dërgon Agjencisë informacionin e parashikuar në ligjin nr.53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, si dhe çdo informacion të kërkuar prej saj, në veçanti në lidhje me:
    - a) pasqyrat kontabël dhe statistikore për veprimet me depozitat gjatë tre muajve të fundit përpara vendosjes së subjektit në likuidim të detyruar;
    - b) të dhëna mbi mashtrimet me depozitat, apo depozitat e përdorura për qëllime të pastrimit të parasë ose financimit të terrorizmit.
  3. Në rastet kur konstatohet se kompensimi është kryer mbi të dhëna të pavërteta dhe të pasakta në listëpagesën e dërguar nga likuidatori, ky i fundit i rimbursion Agjencisë shumën e kompensuar gabimisht.
  4. Agjencia informon likuidatorin për depozituesit dhe shumën e kompensuar sipas listëpagesës.
  5. Në rastin kur procesi i kompensimit kryhet në ambientet e subjektit të vendosur në likuidim të detyruar, likuidatori bashkëpunon me Agjencinë për kryerjen e pagesave të kompensimit."
8. Neni 17 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:
- "1. Drejtori i Përgjithshëm nënshkruan autorizimin për kompensimin e depozitave që i dërgohet bankës agjente, sipas kreut IV të kësaj rregulloreje.
  2. Banka agjente kryen procesin e kompensimit, në emër dhe për llogari të Agjencisë, në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si dhe me kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë.
  3. Banka agjente përdor modulet përkatëse në SIRK, si dhe akseson listëpagesën me të dhëna të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje.
  4. Në raste të jashtëzakonshme të mosfunksionimit të SIRK, Agjencia i dërgon bankës agjente listëpagesën me të dhëna të përcaktuara në aneksin 1 të kësaj rregulloreje nëpërmjet mënyrave alternative të dakordësuara ndërmjet palëve.
  5. Agjencia i transferon bankës agjente mjetet likuide për kompensimin e depozitave, si dhe paguan për ofrimin e këtij shërbimi sipas shumave të negociuara me të, përveç rastit kur ky shërbim ofrohet falas.
  6. Banka agjente i raporton Agjencisë nëpërmjet SIRK raporte periodike, sipas kërkesave të saj dhe në përputhje me kushtet edhe dokumentet tip të parashikuara në kontratën për kryerjen

e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë, në veçanti për:

- a) shumat dhe numrin e depozitueseve që kanë përfituar nga kompensimi;
- b) shumat dhe numrin e depozituesve që kanë mbetur për t'u kompensuar;
- c) ankesat e depozituesve.

7. Banka agjente duhet të përfshijë në Planin e Vijimësisë së Biznesit të saj, planin e veprimit për kryerjen e procesit të kompensimit.

8. Për çështje që nuk janë rregulluar shprehimisht në këtë rregullore dhe në kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë, palët veprojnë në përputhje me ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi."

9. Neni 19 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Depozituesi, për të përfituar kompensimin e depozitës, paraqet dokumentacionin identifikues sipas aneksit 3 të kësaj rregulloreje.

2. Procedura e pagesës së shumës së kompensimit kryhet në përputhje me aneksin 3 të kësaj rregulloreje dhe kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara të nënshkruar me Agjencinë.

3. Banka agjente kryen pagesën e kompensimit vetëm për depozituesit e përfshirë në listëpagesën e depozituesve që përfitojnë kompensim nga skema e sigurimit të depozitave.

4. Banka agjente refuzon kryerjen e pagesës së kompensimit për depozituesit, kur:

- a) ka mospërputhje të të dhënave në listëpagesë me dokumentacionin e paraqitur nga depozituesi;
- b) depozituesi nuk është dakord me shumën e kompensimit;
- c) depozituesi nuk është i përfshirë në listëpagesën e depozituesve."

10. Neni 20 riemërtohet "Ankesat e depozituesve", si dhe ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

"1. Çdo depozitues i subjektit të vendosur në likuidim të detyruar, mund të paraqesë ankesë pranë Agjencisë, ose bankës agjente, në rast refuzimi të pagesës së kompensimit nga banka agjente, sipas pikës 4 të nenit 19 të kësaj rregulloreje, duke plotësuar dokumentet tip të miratuara nga Drejtori i Përgjithshëm i Agjencisë, dhe të publikuara në faqen zyrtare të internetit të Agjencisë.

2. Ankesat për pagesat e kompensimit administrohen në përputhje me aktet e Agjencisë të miratuar për këtë qëllim.
  3. Agjencia, banka agjente dhe likuidatori shkëmbejnë informacione për shqyrtimin e ankesave në modulën e ankesave në SIRK, nëpërmjet përdorueseve të autorizuar të këtij moduli.
  4. Agjencia, shqyrton ankesat e depozituesve së bashku me dokumentacionin mbështetës të paraqitur prej tyre. Për verifikimin e dokumentacionit mbështetës të ankesave, Agjencia bashkëpunon me likuidatorin. Likuidatori i jep Agjencisë të dhënat dhe dokumentacionin për ankesat, nëpërmjet SIRK, brenda 10 ditësh nga kërkesa e Agjencisë. Në këtë rast, afati i shqyrtimit të ankesës ndërpritet dhe rifillon pasi likuidatori të ketë dorëzuar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga Agjencia.
  5. Likuidatori korrigjon të dhënat e listëpagesës sipas vendimit të Agjencisë për ankesat dhe ia dërgon atë asaj në të njëjtën mënyrë sipas nenit 15 të kësaj rregulloreje, brenda 3 ditësh nga marrja e njoftimit për vendimin e Agjencisë.
  6. Në rast se për vlerësimin e ankesës gjykohet se duhet të paraqiten dokumente dhe fakte të tjera që vërtetojnë pretendimin për kompensimin e depozitës, ankimuesi i paraqet ato brenda 10 ditësh nga njoftimi i Agjencisë. Në këtë rast, afati i shqyrtimit të ankesës ndërpritet dhe rifillon pasi Agjencia të ketë siguruar të dhënat dhe dokumentacionin e kërkuar nga ankimuesi.
  7. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Agjencia mund të vendosë:
    - a) pranimin e plotë të ankesës;
    - b) pranimin e pjesshëm të ankesës;
    - c) refuzimin e ankesës.
  8. Në rast se kompensimi i depozitave kryhet në subjektin e vendosur në likuidim të detyruar, likuidatori mban të dhëna të konsoliduara mbi ankesat e depozituesve të paraqitura tek ai dhe informon Agjencinë në lidhje me to sipas kërkesës së saj.
  9. Çdo depozitues ka të drejtën të ankimojë vendimin e Agjencisë pranë Autoritetit Mbikëqyrës brenda afatit 30 ditor të përcaktuar në nenin 132 të Kodit të Procedurës Administrative.”
11. Pas nenit 21, shtohet neni 21/1 me emërtimin “Konfidencialiteti” me përmbajtjen e mëposhtme:

*“Anëtarët e Këshillit Drejtues, Drejtori i Përgjithshëm, punonjësit e Agjencisë, likuidatori, banka agjente, subjektet mbështetëse, si edhe personat e kontraktuar nga Agjencia, ruajnë konfidencialitetin e informacionit që marrin si rezultat i kryerjes së detyrave, gjatë procesit të kompensimit.”*

12. Në nenin 22, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- a. Në pikën 1, shkronja "a", fjalia "Lista paraprahe përbëhet nga jo më shumë se tri banka anëtare të cilat përbushin kriteret e përgjithshme dhe marrin nga vlerësimi i kriterëve teknike pikët më të larta sipas rendit zbritës, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje." zëvendësohet me fjalinë "Lista paraprahe përbëhet nga bankat anëtare të cilat përbushin kriteret e përgjithshme dhe marrin nga vlerësimi i kriterëve teknike pikët më të larta sipas rendit zbritës, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje."
- b. Në pikën 2, fjalia "Në këtë rast, Këshilli Drejtues mund të kërkojë opinionin zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës për përzgjedhjen e bankës agjente në mënyrë të drejtpërdrejtë." zëvendësohet me fjalinë "Në këtë rast, Këshilli Drejtues kërkon opinionin zyrtar të Autoritetit Mbikëqyrës për përzgjedhjen e bankës agjente në mënyrë të drejtpërdrejtë."

13. Në nenin 23, pika 3, fjalia "Autoriteti Mbikëqyrës, me kërkesë të komisionit të përhershëm të vlerësimit, paraqet opinionin zyrtar për gjendjen financiare të bankave anëtare të skemës, i cili përfshin të dhëna jo më të hershme se tre muaj nga data e zhvillimit të vlerësimit.", hiqet nga pika 3 dhe shtohet si pikë 4 në këtë nen, me të njëjtën përmbajtje.

14. Në nenin 24, bëhen ndryshimet e mëposhtme:

a. Pika 5 ndryshohet me përmbajtjen e mëposhtme:

*"5. Këshilli Drejtues shqyrton raportin e komisionit të përhershëm të vlerësimit dhe merr vendim për nënshkrimin e kontratës për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat anëtare të cilat, vlerësohen se:*

- a) përbushin kriteret e përgjithshme; dhe
- b) marrin minimumin e pikëve për përbushjen e kriterëve teknike, sipas aneksit 4 të kësaj rregulloreje."

b. Pika 6 shfuqizohet.

15. Në nenin 25, pika 3, togfjalëshi "...kontratën tip për kryerjen e kompensimit të depozitave me bankat agjente..." zëvendësohet me togfjalëshin "...kontratën për kryerjen e shërbimit të bankës agjente për kompensimin e depozitave të siguruara...".

16. Aneksi 1 i rregullores zëvendësohet me aneksin me të njëjtin titull dhe numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

17. Aneksi 2 i rregullores riemërtohet “Shkresë për dërgimin e listëpagesës”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  18. Aneksi 3 i rregullores zëvendësohet me aneksin me të njëjtin titull dhe numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
  19. Aneksi 4 i rregullores riemërtohet “Kriteret e kualifikimit dhe procedura e vlerësimit të bankave agjente dhe subjekteve mbështetëse”, si dhe zëvendësohet me aneksin me të njëjtin numër, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.
- II. Procedura e përzgjedhjes së bankave agjente, në listën paraprake për periudhën 2024 - 2026, e nisur para hyrjes në fuqi të këtij vendimi, do të vijojë të realizohet sipas kriterëve të kualifikimit të bankave agjente, të përcaktuara në Rregulloren nr. 3762, datë 18.7.2016 “Për kompensimin e depozitave të siguruara” në fuqi, në momentin e fillimit të kësaj procedure.
  - III. Ngarkohet Agjencia e Sigurimit të Depozitave, për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
  - IV. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**

## ANEKSI 1 LISTËPAGESA

### Për individët

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri	Emri
3	Atësia	Atësia
4	Mbiemri	Mbiemri
5	Mbiemri përpara martese	Mbiemri përpara martese
6	Gjinia	Gjinia
7	Rezidenca	01-Rezident 02-Jorezident
8	Statusi i Depozituesit	01 - I punësuar 02 - I papunësuar 03 - Student 04 - Pensionist 05 - Tjetër
9	Tipi i dokumentit të identifikimit	1 – Kartë identiteti 2 – Pasaportë 3 – Të tjera
10	Numri personal i identifikimit të depozituesit	Numri unik i identifikimit sipas dokumentit të identifikimit
11	Numri i dokumentit të identifikimit	Numri i dokumentit të identifikimit
12	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit	Data e lëshimit të dokumentit të identifikimit
13	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit	Data e skadimit të dokumentit të identifikimit
14	Datëlindja	Datëlindja
15	Adresa	Adresa
16	Numri i telefonit	Numri i telefonit
17	E-mail	E-mail
18	Shtetësia	Shteti që ka lëshuar mjetin e identifikimit sipas kodit ISO
19	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t'iu kompensuar depozituesit
20	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

### Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare

Nr.	Përshkrimi	Koment
1	Kodi unik i depozituesit në bankë/SHKK	Sipas të dhënave në bankën/SHKK-në nën likuidim të detyruar
2	Emri i subjektit	Emri i subjektit tregtar
3	Numri unik i identifikimit të subjektit	NUIS
4	Data e regjistrimit të subjektit	Sipas ekstraktit të QKB
5	Forma ligjore	Tregtarë, Shoqëri Aksionare, Shoqëri me përgjegjësi të kufizuar, Shoqëri kolektive, Shoqëri komandite, të tjera
6	Adresa e selisë	Adresa
7	Numri i telefonit	Numri i telefonit
8	E-mail	E-mail
9	Shuma e kompensimit	Shuma totale për t'iu kompensuar subjektit
10	Data e dërgimit të listëpagesës	Data e dërgimit të listëpagesës

## ANEKSI 2

## SHKRESË PËR DËRGIMIN E LISTËPAGESËS

Me anë të kësaj shkrese deklarojmë se informacioni i raportuar në SIRK nëpërmjet ngarkimit të skedarëve sipas formatit standard të përcaktuar me vendim të Këshillit Drejtues të Agjencisë, është në përputhje me kërkesat e ligjit nr. 53/2014, datë 22.5.2014 "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, dhe të rregullores nr. 3762, datë 18.7.2016 "Për kompensimin e depozitave", të ndryshuar.

Njësia që e përgatit informacionin dhe njësia që e monitoron këtë informacion sigurojnë vërtetësinë e regjistrimit të transaksioneve, dhe se informacioni i raportuar Agjencisë në SIRK në dijeninë më të mirë është i vërtetë dhe i saktë. Konfirmojmë se, sistemet e përpunimit të të dhënave të subjektit në likuidim të detyruar përputhen me kërkesat e Agjencisë.

Listëpagesa e depozituesve që kompensohen, e ngarkuar në SIRK, përmban në mënyrë të konsoliduar të dhënat e mëposhtme:

- a) totali i depozitave për t'u kompensuar është \_\_\_\_\_;
- b) numri i depozituesve për t'u kompensuar është \_\_\_\_\_.

Njësia që përgatiti informacionin

Njësia monitoruese

Likuidatori

(emër, mbiemër, pozicion pune, firmë,  
vulë)

(emër, mbiemër, pozicion pune,  
firmë, vulë)

(emër, mbiemër, pozicion  
pune, firmë, vulë)

## **ANEKSI 3**

### **PROCEDURA E PAGESËS SË SHUMËS SË KOMPENSIMIT**

#### **A. Pagesa e kompensimit për depozituesit individë**

Pagesa e kompensimit kryhet si vijon:

1. Konfirmohet identiteti i depozituesit nëpërmjet verifikimit të emrit, mbiemrit dhe numrit personal sipas dokumenteve të identifikimit (pasaportë biometrike ose kartë identiteti), të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës.
2. Pas konfirmimit të identitetit të depozituesit, banka agjente, kryen veprimet nëpërmjet SIRK, sipas manualit të përdorimit të tij, si dhe ngarkon në SIRK dokumentacionin përkatës, që vërteton kryerjen e pagesës, në përputhje me procedurën e përcaktuar nga Agjencia.
3. Pagesa e kompensimit, kryhet me para në dorë (CASH), ose transfertë në një llogari, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri, sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.

#### **B. Pagesa e kompensimit për depozituesit individë me person të autorizuar**

1. Në rastin kur depozituesi përfaqësohet nga personi i autorizuar, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të personit të autorizuar. Personi i autorizuar paraqet prokurën origjinale, të posaçme për pagesën e kompensimit. Prokura e përfaqësuesit të depozituesit duhet të përmbajë të dhënat e dokumentit identifikues të depozituesit, të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës.
2. Prokurat e hartuara jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë duhet të jenë të legalizuara me vulën apostille, e lëshuar nga autoriteti përkatës kompetent i vendit ku është lëshuar prokura. Për ato shtete, të cilat nuk janë palë në Konventën e Hagës, prokura duhet të jetë e legalizuar nga autoriteti përkatës kompetent i vendit, ku është lëshuar prokura. Dokumentacioni, në çdo rast, duhet të shoqërohet me përkthim të noterizuar në gjuhën shqipe.
3. Pas konfirmimit të identitetit të personit të autorizuar, banka agjente kryen veprimet sipas përcaktimit në shkronjën "A", pika 2 të këtij aneksi.
4. Pagesa e kompensimit kryhet me para në dorë (CASH) ose transfertë në një llogari në njërën nga bankat që operojnë në Shqipëri, sipas përcaktimeve në nenin 14 të kësaj rregulloreje.



### C. Pagesa e kompensimit për depozituesit e mitur

1. Në rastin kur depozituesi është i mitur, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të përfaqësuesit ligjor të të miturit, i cili mund të jenë prindi ose kujdestari ligjor.
2. Dokumentet që paraqiten nga përfaqësuesi ligjor i të miturit janë:
  - a) certifikatë personale/pasaportë e të miturit;
  - b) certifikatë familjare e të miturit;
  - c) vendimi i kujdestarisë sipas rastit;
  - ç) dokumenti identifikues i përfaqësuesit ligjor të të miturit.
3. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në Lek, në emër të të miturit, në njërën nga bankat që operojnë në Shqipëri. Përfaqësuesi ligjor që jep numrin e llogarisë bankare duhet të sigurohet që ajo të ketë statusin aktiv.

### Ç) Pagesa e kompensimit për depozituesit me zotësi të kufizuar për të vepruar ose pa zotësi për të vepruar

1. Në rastin kur depozituesi është person me zotësi të kufizuar ose nuk ka zotësi për të vepruar, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të përfaqësuesit ligjor të tij.
2. Dokumentet që paraqiten nga përfaqësuesi ligjor i këtij depozituesi janë:
  - a) dokument identifikimi i personit me zotësi të kufizuar për të vepruar ose pa zotësi për të vepruar;
  - b) dokument identifikimi i përfaqësuesit ligjor;
  - c) vendimin e institucionit që përcakton përfaqësuesin ligjor, sipas rastit.
3. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në Lek, në emër të këtij depozituesi, në njërën nga bankat që operojnë në Shqipëri. Personat që japin numrin e llogarisë bankare duhet të sigurohen që ajo të ketë statusin aktiv.

### D. Pagesa e kompensimit për trashëgimtarët

1. Pagesa e shumës për kompensim për trashëgimtarët e depozituesit kryhet vetëm nëse paraqitet akti për ndarjen e trashëgimisë sipas ligjeve në fuqi. Në këtë rast, banka agjente kryen edhe verifikimin e identitetit të trashëgimtarëve.
2. Në rastet kur titullari me të drejta të plota i depozitës ka vdekur (mortis causa), dhe ky fakt nuk ishte i njohur për likuidatorin në kohën e përgatitjes së listëpagesës, banka agjente nuk kryen pagesën, por informon Agjencinë për rastin në fjalë.
3. Agjencia kërkon nga likuidatori rishikimin e listëpagesës në bazë të aktit për ndarjen e trashëgimisë sipas ligjeve në fuqi.
4. Pas rishikimit nga likuidatori, Agjencia i dërgon bankës agjente

listë pagesën e përditësuar e cila kryen veprimet për kompensimin sipas rasteve të përcaktuara në këtë aneks.

### **Dh. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë ose shoqëritë tregtare**

1. Pagesa e kompensimit për depozituesit tregtarë dhe shoqëritë tregtare kryhet nëpërmjet paraqitjes së dokumenteve vijues:
  - a) Ekstraktit origjinal nga Qendra Kombëtare e Biznesit të tregtarit/shoqërisë tregtare, i cili mban datë jo më të hershme se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit. Emri i administratorit që është paraqitur për të përfituar shumën e kompensimit duhet të jetë në ekstraktin e QKB.
  - b) Certifikata e regjistrimit të tregtarit/shoqërisë tregtare në organin tatimor, ose kopje e noterizuar e saj jo më herët se 10 ditë nga paraqitja për përfitimin e kompensimit;
  - c) Dokument identifikimi (ID/pasaportë) të administratorit të subjektit tregtar.
2. Pagesa e kompensimit bëhet nëpërmjet transfertës në një llogari bankare, në Lek, në emër të depozituesit tregtar ose shoqërisë tregtare, në njërën nga bankat, që operojnë në Shqipëri, sipas informacionit që jepet nga administratori i subjektit tregtar.
3. Në rastin kur tregtari ose shoqëria tregtare përfaqësohet nga një person i autorizuar, përveç dokumenteve të përcaktuara në shkronjën "Dh", pika 1, të këtij aneksi, duhet të paraqitet edhe prokura origjinale e posaçme për pagesën e kompensimit. Prokura duhet të lëshohet nga përfaqësuesi i subjektit, emri i të cilit duhet të jetë i përfshirë në Ekstraktin e QKB. Prokura duhet të përmbajë të dhënat e subjektit, të cilat duhet të përputhen me të dhënat e listëpagesës, si dhe të dhënat e personit të autorizuar sipas dokumentit të identifikimit. Në prokurë duhet përcaktohet detyrimisht numri i llogarisë bankare në Lek, në emër të tregtarit ose shoqërisë tregtare, si dhe emri i saktë i bankës që operon në Shqipëri, në të cilën do të transferohet shuma e kompensimit.

\* Banka agjente mund të kërkojë çdo dokument tjetër që konsiderohet i nevojshëm sipas rastiit dhe në përputhje me ligjet në fuqi.

## ANEKSI 4

### KRITERET E KUALIFIKIMIT DHE PROCEDURA E VLERËSIMIT TË BANKAVE AGJENTE DHE SUBJEKTEVE MBËSHTETËSE

#### 4.1 Kriteret e kualifikimit të bankave agjente

Bankat agjente kualifikohen, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme:

##### 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të bankave agjente

- a) Banka nuk ka masa mbikëqyrëse të vendosura nga Banka e Shqipërisë, në përputhje me dispozitat e ligjit "Për bankat", të ligjit "Për ndërhyrjen e jashtëzakonshme" dhe të kuadrit rregullativ mbikëqyrës të nxjerrë në bazë dhe për zbatim të tyre, në momentin e paraqitjes së dokumentacionit;
- b) Profili i përgjithshëm i rrezikut të bankës është vlerësuar 1-3 sipas Bankës së Shqipërisë.

##### 2. Kriteret teknike të vlerësimit të bankave agjente

###### Pikët

a)	Numri i degëve dhe agjencive, si dhe shpërndarja e detajuar gjeografike, përfshirë postet përkatëse të punës arkë, shërbim klienti dhe rrjeti i ATM	25%
b)	Aftësia për furnizimin dhe kapaciteti ditor i përpunimit të parasë në dorë (CASH) sipas secilës degë	10%
c)	Aftësitë teknike të bankës agjente për të automatizuar proceset e brendshme për të përshpejtuar pagesat për kompensim	20%
ç)	Koha mesatare (në minuta) për 1 transaksion në arkë	5%
d)	Koha mesatare (në minuta) për 1 transaksion transfertë	5%
dh)	Koha mesatare (në minuta) për hapjen e një llogarie të re	5%
e)	Numri i operatorëve dhe kapaciteti përpunues i call center	5%
ë)	Aftësia e bankës agjente për të ofruar mjete alternative pagese në rast kompensimi	5%
f)	Poste pune të dedikuara për kompensim (sipas degëve) në dispozicion	10%
g)	Poste pune shtesë për kompensim, arkë ose shërbim klienti	5%
gj)	Mundësia për ofruar orë pune shtesë për kompensim, arkë ose shërbim klienti	5%
	Total (Propozimi Teknik)	100%

Minimumi i pikëve të propozimit teknik për t'u përfshirë në listën paraprake është 60%.

Fituese përzgjidhet banka agjente, e cila është vlerësuar me maksimumin e përqindjes për propozimin teknik dhe ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Në rastin kur dy banka agjente janë vlerësuar me përqindje të njëjta më të larta të propozimit teknik, fituese

do të përzgjidhet banka agjente e cila ka paraqitur ofertën ekonomike falas ose me çmimin më të ulët. Oferta ekonomike paraqitet në vlerë në Lekë.

\* Bankat agjente duhet të dorëzojnë dokumente origjinale, ose të noterizuara, të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së procedurës.

## 4.2 Kriteret e kualifikimit të subjekteve mbështetëse

Subjektet mbështetëse kualifikohen, pasi të kenë përmbushur kriteret e mëposhtme:

### 1. Kriteret e përgjithshme të përzgjedhjes të subjekteve mbështetëse

- a) Subjekti është i regjistruar në regjistrin tregtar dhe ka objektin e aktivitetit të kërkuar nga Agjencia.
- b) Subjekti nuk është në proces falimentimi dhe/ose likuidimi (statusi aktiv).
- c) Personi (personat) që veprojnë si administrator/aksioner/ortak të subjektit mbështetës, nuk është i dënuar nga një vendimi i gjykatës i formës së prerë për vepër penale.
- ç) Subjekti ka shlyer detyrimet në lidhje me taksat dhe tatimet.
- d) Subjekti ka shlyer detyrimet në lidhje me kontributet e sigurimeve shoqërore.
- dh) Subjekti nuk është në kushtet e konfliktit të interesit, sipas legjislacionit në fuqi.

### 2. Kriteret teknike të përzgjedhjes të subjekteve mbështetës

- a) Kontrata të ngjashme me objektin e kontratës të kërkuar nga Agjencia.
- b) Licenca profesionale të nevojshme për zbatimin e objektit të kontratës të kërkuar nga Agjencia.
- c) Kualifikime teknike dhe profesionale të stafit përgjegjës për përmbushjen e objektit të kontratës të kërkuar nga Agjencia.
- ç) Personeli i nevojshëm për të zbatuar kontratën.
- d) Dëshmi të mjeteve, pajisjeve teknike të nevojshme për të përmbushur kontratën, siç kërkohet nga Agjencia.

### 3. Kriteret financiare të përzgjedhjes të subjekteve mbështetës

- a) Kopje të certifikuara të bilanceve të një ose më shumë viteve, të paraqitura nga autoritetet përkatëse dhe raporteve të auditit financiar, të certifikuara nga një subjekt i licencuar auditimi;
- b) Kopje të deklaratave të xhiros vjetore.

\* Subjektet duhet të dorëzojnë dokumente origjinale, ose të noterizuara, të lëshuara jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së procedurës.

### 4.3 Procedura e vlerësimit të bankave agjente dhe subjekteve mbështetëse

#### A. Vlerësimi për kriteret e përgjithshme dhe teknike

1. Anëtarët e komisionit/njesisë të vlerësimit deklarojnë konfliktin e interesit dhe përbushin gjatë gjithë procedurës detyrimin për ruajtjen e konfidencialitetit.
2. Komisioni/njësia mban procesverbale dhe dokumentacion për zbatimin e procedurave të përzgjedhjes, të cilat të përfshijnë, informacion mbi kërkesat për pjesëmarrje dhe ofertat e paraqitura, kontratat e nënshkuara dhe zbatimin e tyre.
3. Zarfat për pjesëmarrje në procedurën e kualifikimit pranohen dhe hapen njëkohësisht, në prani të anëtarëve të komisionit/njesisë në një ditë të vetme, pas përfundimit të afatit të përcaktuar për dorëzimin e tyre.
4. Zarfat e dorëzuar në komision/njësi përtej afatit të pranimit të tyre, nuk pranohen dhe i kthehen bankës/subjektit përkatës.
5. Nëse komisioni/njësia vëren se banka/subjekti ka mangësi në dokumentacion ata vendosin njoftimin e saj/tij dhe afatin për plotësimin e mangësive. Njoftimi i bankës/subjektit kryhet nga anëtari i autorizuar i komisionit/njesisë. Procesi i vlerësimit pezullohet deri në plotësimin e dokumentacioneve sipas njoftimit të komisionit/njesisë.
6. Komisioni/njësia vlerëson dokumentet e dorëzuara nga banka/subjekti, për përputhshmërinë e këtij dokumentacioni me kërkesat për kualifikim.
7. Si rregull, afati i shqyrtimit të dokumenteve përcaktohet nga komisioni/njësia. Ky afat mund të shtyhet sipas vendimit të komisionit/njesisë duke njoftuar Këshillin Drejtues të Agjencisë/Drejtorin e Përgjithshëm.
8. Banka/subjekti që nuk i plotëson kriteret, skualifikohet dhe njoftohet për këtë skualifikim brenda shtatë ditësh nga marrja e vendimit.

#### B. Skualifikimi

1. Agjencia s'kualifikon çdo bankë/subjekt që paraqet të dhëna të rreme për qëllime kualifikimi, në çdo kohë deri në fazën e shpalljes së kontratës fituese.
2. Agjencia përjashton nga pjesëmarrja në procedurat e përzgjedhjes çdo bankë/subjekt, kur ka të dhëna se janë të dënuar me vendim gjyqate të formës së prerë për ndonjë nga veprat penale të mëposhtme:
  - a) pjesëmarrje në organizatë kriminale;
  - b) korrupsion;
  - c) mashtrim;
  - ç) pastrim parash;

- d) falsifikim.
3. Agjencia mund t'i kërkojë çdo banke/subjekti, të paraqesë dokumente dhe, kur ka dyshime, mund t'u drejtohet organeve kompetente për të marrë informacionin e nevojshëm për integritetin dhe gjendjen financiare të subjekteve në fjalë.
4. Vendimi për skualifikimin mund të merret nga Agjencia edhe në rast se:
- a) banka/subjekti (ose stafi i tyre) shkelin ligjin nr. 53/2014, datë 22.5.2014, "Për sigurimin e depozitave", të ndryshuar, dhe aktet nënligjore në fuqi,
  - b) ka mospërputhje të bankës/subjektit me kriteret dhe kërkesat e Agjencisë të evidentuar gjatë verifikimit dhe raportimit,
  - c) banka/subjekti nuk ka përmbushur në mënyrë të kënaqshme kontratat e mëparshme me Agjencinë.
5. Vendimi për skualifikimin e bankës/subjektit merret nga Këshilli Drejtues i Agjencisë/Drejtori i Përgjithshëm sipas propozimit të komisionit/njesisë të vlerësimit. Njoftimi për këtë i dërgohet bankës/subjektit jo më vonë se 7 ditë pune nga data e marrjes të vendimit përkatës.



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**GUVERNATORI**

Nr. 2852

Tiranë, më 28.6.2024

**VENDIM**  
Nr. 2852, datë 28.6.2024

**PËR**  
**CAKTIMIN E SHITESËS KUNDËRCIKLIKE TË KAPITALIT**

Në bazë dhe për zbatim të neneve 11, 12 dhe nenit 16, pika 1, shkronja "ç", të rregullores "Për shtesat makroprudenciale të kapitalit" miratuar me vendimin nr. 41, datë 5.6.2019 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, bazuar në propozimin e Departamentit të Stabilitetit Financiar,

VENDOSA:

1. Norma e shtesës kundërciklike të kapitalit (KUNC) për Shqipërinë rritet në 0.25 (zero pikë njëzet e pesë) për qind.
2. Bankat duhet të raportojnë shkallën e përmbushjes së shtesës kundërciklike të kapitalit sipas paragrafit 1, duke filluar me datën 30 qershor 2025.
3. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në faqen zyrtare dhe në Buletin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.
4. Ngarkohen Departamenti i Stabilitetit Financiar dhe Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**GUVERNATOR**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I MBIKËQYRJES**

Nr. 5024 prot.

Tiranë, më 17.7.2024

**VENDIM**  
Nr. 5024, datë 17.7.2024

**PËR  
PEZULLIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE FINANCIARE DHE  
MARRJEN E MASAVE MBIKËQYRËSE PËR SHOQËRINË E KURSIM  
KREDITIT "RRUSHKULL ONE"**

Në bazë të raportit të ekzaminimit të veprimtarisë së Shoqërisë së Kursim-Kreditit "Rrushkull One" për periudhën 31 korrik 2021– 31 dhjetor 2023, grupi i inspektorëve të Departamentit të Mbikëqyrjes ka konstatuar një sërë problematikash dhe mangësish, të cilat përbëjnë shkelje të kërkesave të ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", si dhe të rregulloreve që Banka e Shqipërisë ka nxjerrë në zbatim të këtij ligji. Gjatë ekzaminimit janë evidentuar shkeljet e mëposhtme:

- I. Shkelje të ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre":
  1. Shkelje të nenit 76, pika 1, shkronjat "b", "c" dhe "f", të ligjit 52/2016 për sa i përket:
    - paraqitjes së pasaktë të pasqyrave financiare të shkk-së;
    - mosrespektimin e normave mbikëqyrëse (RMK, ekspozimet e mëdha, likuiditeti dhe pozicioni i hapur valutor);
    - raportimin e pasaktë të RMK-së për SHKK;
    - raportimin e pasaktë të nivelit të provigjoneve, të ardhurave dhe shpenzimeve;
  2. Shkelje të nenit 76, pika 1, shkronja "ë" të ligjit 52/2016 për sa i përket mos raportimit në Regjistrin e Kredive;
  3. Shkelje të nenit 20, pika 3, shkronja "c" dhe nenit 31, pika 7, të ligjit 52/2016, për sa i përket mungesës së vendimit për miratimin e shpërblimeve të anëtarëve të organeve drejtuese;



4. Shkelje të nenit 29 pika 1, shkronja "ë", të ligjit 52/2016, për sa i përket mungesës së miratimit të planit vjetor të punës dhe paraqitjes së buxhetit vjetor në asamble;
  5. Shkelje të nenit 32, pikat 4, 5 dhe 6, të ligjit 52/2016, sa i takon ushtrimin të detyrave nga audituesi ligjor;
- II. Shkelje të ligjit nr. 9917, datë 19.05.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave e financimin e terrorizmit" (i ndryshuar):
1. Shkelje të nenit 11 të ligjit nr. 9917, lidhur me rishikimin e kuadrit rregullativ të shkk-së;
  2. Shkelje të kreut III, të ligjit nr. 9917, lidhur me analizimin e profilit të klientit, transaksioneve të kryera dhe marrjen e informacionit mbi burimin e të ardhurave;
  3. Shkelje të nenit 12, pika 3, e ligjit nr. 9917, lidhur me raportimin e të gjitha transaksioneve mbi vlerën 1 milionë lekë;
- III. Shkelje të nenit 76, pika 1, shkronjat "c" dhe "ç" të ligjit 52/2016, duke mos respektuar kërkesat e rregullores "Për administrimin e rrezikut në veprimtarinë e shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre" miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 105, datë 5.10. 2016" (më poshtë referuar si "rregullorja e administrimit të rrezikut"):
1. Shkelje e nenit 6 të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me mungesën e sistemit të administrimit të rrezikut;
  2. Shkelje të nenit 8, pika 1, të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me mungesën e politikës së shpërblimeve në SHKK;
  3. Shkelje të nenit 9, pika 2, të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me mosrespektimin e nivelit minimal të raportit të mjaftueshmërisë së kapitalit;
  4. Shkelje të nenit 9, pika 4, të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me llogaritjen e pasaktë të aktiveve të ponderuara me rrezik;
  5. Shkelje të nenit 10, pika 3, të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me tejkalimin e ekspozimeve të shkk-së ndaj një personi ose grup personash të lidhur;
  6. Shkelje të nenit 11, pika 2, të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me mosrespektimin e nivelit maksimal të pozicionit të hapur valutor;
  7. Shkelje të nenit 20, pika 3, shkronjat "a" dhe "b" të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me mosrespektimin e nivelit minimal të treguesve të likuiditetit;
  8. Shkelje të nenit 31 të rregullores së administrimit të rrezikut lidhur me raportimin në Regjistrin e Kredisë pranë Bankës së Shqipërisë;

- IV. Shkelje të nenit 76, pika 1, shkronja "ç", të ligjit 52/2016, duke mos respektuar kërkesat e rregullores nr. 104, datë 5.10.2016 "Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë së shoqërive të kursim-kreditit dhe të unioneve të tyre:
1. Shkelje të nenit 25, në lidhje me bashkimin me përthithje të shkk-së "Perlat" pa miratimin paraprak me shkrim të Bankës së Shqipërisë, si dhe jo në përputhje me planin e biznesit paraqitur që në momentin fillestar të licencimit.
- V. Shkelje të nenit 11 të rregullores "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr. 44, datë 10.6.2009, e ndryshuar, lidhur me raportimin e të dhënave të kërkuara sipas anekseve 3 dhe 4 të kësaj rregullore.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 32, pika 9, të nenit 76, të nenit 77, shkronjat "a", "c" "ç" dhe "f", të nenit 78, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 52/2016 datë 19.5.2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", të nenit 11 të rregullores "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.44, datë 10.6.2009, e ndryshuar si dhe të shtojcës nr. 4, seksioni IV, pikat 1, 15 dhe 16 të rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.5.2010, e ndryshuar, Departamenti i Mbikëqyrjes,

#### URDHËROJ:

1. Pezullimin e ushtrimit të veprimtarive financiare për të cilat është licencuar për një periudhë 6-mujore (31 janar 2025). Gjatë periudhës së pezullimit, SHKK "Rrushkull One" nuk mund të ushtrojë aktivitetin e kredihënies si dhe nuk lejohet mbledhja e depozitave në çdo formë, përfshirë edhe depozitimet në llogari rrjedhëse. Gjatë periudhës së pezullimit, lejohet vetëm tërheqja e depozitave dhe shlyerja e kësteve të kredisë nga anëtarë të SHKK-së, si dhe transferimi i depozitave dhe kredive për qëllime të bashkimit me përthithje me shkk "Perlat".
2. Kufizimin e rritjes së mjeteve financiare, duke përfshirë zërat jashtë bilancit me rrezik gjatë periudhës së pezullimit të ushtrimit të veprimtarive financiare për një periudhë 6-mujore (deri në 31 janar 2025).
3. Ndalimin e rritjes së ekspozimit ndaj një anëtarë ose pale të tretë për një periudhë 6-mujore (31 janar 2025).
4. Ndalimin e kryerjes së çdo lloj investimi për një periudhë 6-mujore (31 janar 2025).

5. SHKK "Rrushkull One" të përfundojë procesin e bashkimit me përthithje me SHKK-në "Perlat", brenda datës 31 dhjetor 2024.
6. SHKK "Rrushkull One" të ndryshojë audituesin ligjor që do të auditojë pasqyrat financiare për vitin 2024 brenda një periudhe 6-mujore (31 janar 2025).
7. SHKK "Rrushkull One" të aplikojë për t'u përfshirë në regjistrin e kredisë, si dhe të marrë masa për të përfunduar proceset teknike brenda datës 30 nëntor 2024.
8. Ndërprerjen e veprimeve në kundërvajtje dhe marrjen e masave për përmirësimin e situatës, duke paraqitur planin përkatës të masave për miratim në Bankën e Shqipërisë me qëllim përmbushjen e rekomandimeve të lëna në Raportin e Ekzaminimi nr. 4962, datë 15.7.2024, brenda datës 15.8.2024. Gjithashtu, të raportojë çdo 3 muaj në Departamentin e Mbikëqyrjes mbi ecurinë e realizimit të këtij plani.
9. SHKK "Rrushkull One" ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë Guvernatorit sipas pikës 1 të nenit 80 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 "Për shoqëritë e kursim kreditit dhe unionet e tyre", brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për aktin.
10. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
11. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Me respekt,

**DREJTOR**

**DENIZ DERALLA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
DEPARTAMENTI I MBIKEQYRJES**

Nr. 5416 prot.

Tiranë, më 2.8.2024

**VENDIM**  
Nr. 5416, datë 2.8.2024

**PËR  
PEZULLIMIN E USHTRIMIT TË VEPRIMTARIVE FINANCIARE TË  
SHOQËRISË SË KURSIM-KREDITIT "PERLAT" DHE PËRFUNDIMIN E  
PROCESIT TË BASHKIMIT ME PËRTHITHJE ME SHOQËRINË E KURSIM-  
KREDITIT "RRUSHKULL ONE"**

Në bazë të nenit 71, pika 1, e ligjit nr. 52/2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", SHKK-të nuk mund të ushtrojnë veprimtarinë pa realizuar sigurimin e depozitave sipas dispozitave të ligjit nr. 53/2014 "Për sigurimin e depozitave".

Me vendimin nr. 40, datë 24.11.2016, Agjencia e Sigurimit të Depozitave ka refuzuar kërkesën e SHKK "Perlat" për anëtarësimin në skemën e sigurimit të depozitave.

Pas komunikimeve me Bankën e Shqipërisë (shkurt 2018), ku SHKK-së i kërkohet likuidimi vullnetar i shoqërisë, në mars 2018, SHKK "Perlat" ka njoftuar se do të mbështeste krijimin e një shoqërie të re, e cila do të përthithte edhe SHKK "Perlat" (Vendim i Asamblesë dt. 28.3.2018). Me licencën nr. 178, datë 29.7.2021, Banka e Shqipërisë ka licencuar SHKK-në "Rrushkull One", e cila është anëtarësuar në skemën e sigurimit të depozitave në gusht 2021. Në plan biznesin e paraqitur nga SHKK "Rrushkull One" në momentin e licencimit, është parashikuar dhe procesi i bashkimit me përthithje me SHKK "Perlat" (ku SHKK "Rrushkull One" do të ishte shoqëria përthithëse). Për më shumë se tre vjet, ky proces nuk është realizuar.

Në bazë dhe për zbatim të nenit 76, pika 1, shkronja "k" dhe nenit 78, pika 1, shkronja "c", të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016, "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", si dhe të shtojcës

nr. 4, seksioni IV, pika 16 e rregullores "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare", miratuar me vendim të Këshillit Mbikëqyrës nr.36, datë 26.5.2010, e ndryshuar,

### URDHËROJ:

1. Pezullimin e ushtrimit të veprimtarisë së kredihënies dhe mbledhjes së depozitave të reja në çdo formë nga anëtarët e saj, të SHKK "Perlat" deri në datën 31 dhjetor 2024.
2. Gjatë periudhës së pezullimit, lejohet vetëm tërheqja e depozitave me kërkesën e anëtarëve, shlyerja e kësteve të kredisë nga anëtarët e SHKK-së dhe transferimi i depozitave dhe kredive për qëllime të bashkimit me përthithje me SHKK "Rushkull One".
3. Gjatë periudhës së pezullimit, SHKK "Perlat" duhet të marrë të gjitha masat dhe vendimet e nevojshme për të finalizuar bashkimin me përthithje me SHKK "Rushkull One".
4. SHKK "Perlat" ka të drejtë të paraqesë ankim administrativ pranë Guvernatorit sipas pikës 1 të nenit 80 të ligjit nr. 52/2016, datë 19.5.2016 "Për shoqëritë e kursim-kreditit dhe unionet e tyre", brenda 30 ditëve nga data e marrjes së njoftimit për aktin.
5. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
6. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**DREJTOR**

**DENIZ DERALLA**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 40, datë 7.8.2024

**PËR  
MIRATIMIN E RAPORTIT TREMUJOR TË POLITIKËS MONETARE**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronja "ç" dhe të nenit 69, pika 5 të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë" i ndryshuar, me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë "Raportin tremujor të politikës monetare", sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohet Departamenti i Kërkimeve për publikimin dhe për dërgimin e këtij raporti në Kuvendin e Shqipërisë, në Këshillin e Ministrave dhe në institucionet e tjera përkatëse.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 41, datë 7.8.2024

**PËR**  
**MBAJTJEN E PANDRYSHUAR TË NORMËS SË INTERESIT TË**  
**MARRËVESHJEVE TË RIBLERJES DHE TË ANASJELLA TË RIBLERJES**  
**DHE TË NORMAVE TË INTERESIT TË DEPOZITËS NJËDITORE DHE TË**  
**KREDISË NJËDITORE NË BANKËN E SHQIPËRISË**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 43, shkronjat "a" dhe "c", të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997, "Për Bankën e Shqipërisë", të ndryshuar; me propozimin e Departamentit të Politikës Monetare, Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë,

**VENDOSI:**

1. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 3.00 për qind, normën e interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes (REPO dhe REPO të anasjella).
2. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 2.00 për qind, normën e interesit që Banka e Shqipërisë i paguan një banke tregtare për depozitën njëditore.
3. Të mbajë të pandryshuar, në nivelin 4.00 për qind, normën e interesit që një bankë tregtare i paguan Bankës së Shqipërisë për kredinë njëditore.
4. Ngarkohet Departamenti i Operacioneve Monetare të njoftojë menjëherë bankat tregtare për këtë vendim.
5. Ngarkohen Departamenti i Operacioneve Monetare dhe të gjitha strukturat e tjera në Bankën e Shqipërisë për zbatimin e këtij vendimi.

6. Ngarkohet Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve për publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në faqen zyrtare të internetit dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**SEKRETARI**

**KRYETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**GENT SEJKO**





**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BANKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 42, datë 7.8.2024

**PËR  
DISA NDRYSHIME NË RREGULLOREN  
“PËR LICENCIMIN, USHTRIMIN E VEPRIMTARISË, REVOKIMIN E  
LICENCËS DHE LIKUIDIMIN E PORTOFOLIT TË KREDIVE TË KRIJUAR  
NGA USHTRIMI I VEPRIMTARISË FINANCIARE NGA SUBJEKTET  
FINANCIARE JOBANKA”**

Në bazë dhe për zbatim të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 12, shkronja “a” dhe të nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; dhe të nenit 126 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Në rregulloren “Për licencimin, ushtrimin e veprimtarisë, revokimin e licencës dhe likuidimin e portofolit të kredive të krijuar nga ushtrimi i veprimtarisë financiare nga subjektet financiare jobanka”, miratuar me vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 01, datë 17.1.2013, e ndryshuar, të bëhen ndryshimet e mëposhtme:
  - a) Pas nenit 6, shtohet neni 6/1 me përmbajtjen e mëposhtme:

## "Neni 6/1 Forma ligjore

*Forma ligjore e shoqërisë që kërkon të ushtrojë veprimtari financiare si subjekt financiar jobankë ose si institucion financiar i mikrokredisë, me përjashtim të subjekteve që kërkojnë të ushtrojnë vetëm veprimtaritë financiare të faktoringut dhe/ose të qirasë financiare, duhet të jetë shoqëri aksionare, sipas dispozitave të parashikuara në ligjin "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare".;*

b) Në nenin 8 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. në pikën 1 dhe në pikën 2, shkronjat "f", "h" dhe "i", kudo pas fjalës "themeluesit", shtohet togfjalëshi "/aksionerët/ortakët";
- ii. në pikën 2, shkronja "d", togfjalëshi "Qendra Kombëtare e Regjistrimit", zëvendësohet me togfjalëshin "Qendra Kombëtare e Biznesit";
- iii. në pikën 2, shkronja "g", nën pikat "i" dhe "ii", pas fjalës "themeluesve", shtohet togfjalëshi "/aksionerëve/ortakëve", dhe në shkronjën "i", pas fjalës "themeluesi", shtohet togfjalëshi "/aksioneri/ortaku";
- iv. në pikën 2, përmbajtja e shkronjës "j" ndryshon si më poshtë:

*"j) dokumentacioni për kryetarin e këshillit të administrimit/mbikëqyrës, administratorin dhe kryetarin e komitetit të kontrollit, siç parashikohet në nenin 9/1 të kësaj rregulloreje dhe dokumentacioni i mëposhtëm:";*

c) Në nenin 9, pika 1, pas togfjalëshit "Subjekti financiar jobankë dhe institucioni financiar i mikrokredisë", shtohet togfjalëshi "krijon organet e parashikuara në nenin 134 të ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare" dhe,;"

d) Në nenin 10 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. në pikën 1, shkronja "a" dhe në pikën 2, shkronjat "b" dhe "d", pas fjalës "themeluesit", shtohet togfjalëshi "/aksionerët/ortakët";
- ii. në pikën 1, shkronja "b" dhe në pikën 2, shkronja "c", pas fjalës "themeluesve", shtohet togfjalëshi "/aksionerëve/ortakëve";

e) Në nenin 14, pika 1, shkronja "b" pas fjalës "themeluesit", shtohet togfjalëshi "/aksionerët/ortakët" dhe në shkronjën "g", pas fjalës "themeluesve", shtohet togfjalëshi "/aksionerëve/ortakëve";

f) Në nenin 17, pika 1, shkronja "d", nën pika "ii", fjala "QKR", zëvendësohet me togfjalëshin "Qendra Kombëtare e Biznesit";

g) Në nenin 19, pika 1, shkronja "b", togfjalëshi "Qendra Kombëtare

e Regjistrimit”, zëvendësohet me togfjalëshin “Qendra Kombëtare e Biznesit”;

h) Në nenin 21 bëhen ndryshimet e mëposhtme:

- i. në pikën 1, shkronja “d”, togfjalëshi “paragrafi 3”, zëvendësohet me togfjalëshin “paragrafi 2”;
- ii. pas pikës 2, shtohen pikat 3, 4 dhe 5 me përmbajtjen e mëposhtme:

*“3. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, në rastin e zmadhimit të kapitalit të shoqërisë, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:*

- a) vendimin e asamblesë së aksionerëve/ortakëve për zmadhimin e kapitalit;
- b) relacionin shoqërues për rritjen e kapitalit;
- c) deklaratën noteriale lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje.

4. Subjekti financiar jobankë ose institucioni financiar i mikrokredisë, në rastin e ndryshimeve në strukturën e kapitalit, paraqet në Bankën e Shqipërisë dokumentacionin e mëposhtëm:

- a) aktin për veprimin juridik përkatës, që sjell më pas ndryshimet në strukturën e kapitalit;
- b) vendimin e organit drejtues të shoqërisë për dhënien e pëlqimit për kalimin e pronësisë të aksioneve/kuotave (nëse është e aplikueshme);
- c) relacionin shoqërues për ndryshimet në strukturën e kapitalit;
- d) deklaratën noteriale të aksionerëve/ortakëve përfitues lidhur me burimin e krijimit të kapitalit, të shoqëruar me dokumentacion justifikues sipas përcaktimit të shkronjës “g” të pikës 2 të nenit 8 të kësaj rregulloreje;
- e) vërtetime, për aksionerët/ortakët përfitues, të lëshuara nga organet kompetente sipas juridiksionit përkatës, se:
  - i. personi nuk është në ndjekje penale (kur është e aplikueshme),
  - ii. personi nuk është në gjykim për vepra penale (kur është e aplikueshme),
  - iii. personi nuk është i dënuar penalisht (kur është e aplikueshme),
  - iv. personi nuk është në proces ekzekutimi të detyrueshëm për detyrime pasurore të pashlyera,
  - v. ndaj personit nuk kanë filluar procedura të paafësisë paguese, të falimentimit ose të likuidimit, etj. (kur është e aplikueshme).

Vërtetimet e lartpërmendura të jenë lëshuar jo më herët se 3 (tre) muaj nga data e paraqitjes së njoftimit në Bankën e Shqipërisë.

- f) deklaratën e aksionerit/ortakut përfutues, e cila përmban informacion për marrëdhënie të ngushta personale, pune apo biznesi sipas përcaktimeve ligjore, me persona për të cilët ka dënime penale të formës së prerë (sipas formularit nr. 11 të kësaj rregulloreje).
5. Banka e Shqipërisë, nëse e çmon të nevojshme, mund të kërkojë rast pas rasti edhe dokumente apo informacione shtesë, përveç sa është parashikuar në këtë nen.”;
- i) Në nenin 32, bëhen ndryshimet e mëposhtme:
- i. pikat 1 dhe 2 shfuqizohen;
  - ii. pas pikës 3, shtohen pikat 4 dhe 5 me përmbajtjen e mëposhtme:  
“4. Subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë, me përjashtim të subjekteve që ushtrojnë vetëm veprimtaritë financiare të faktoringut dhe/ose të qirasë financiare, të licencuara si shoqëri me përgjegjësi të kufizuar (sh.p.k) nga Banka e Shqipërisë përpara datës 1 shtator 2024, marrin masat e nevojshme për të përmbushur kërkesën në lidhje me formën ligjore, në përputhje me kërkesat e nenit 6/1 të kësaj rregulloreje, dhe krijimin e organeve sipas përcaktimeve të ligjit “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, si dhe njoftojnë Bankën e Shqipërisë, brenda datës 31 mars 2025. Këto subjekte gjithashtu paraqesin në Bankën e Shqipërisë, dokumentacionin e parashikuar në nenin 9/1 dhe sigurojnë plotësimin e kërkesave të nenit 9/2 të kësaj rregulloreje, brenda datës 31 dhjetor 2025.
5. Subjektet financiare jobanka dhe institucionet financiare të mikrokredisë të licencuara nga Banka e Shqipërisë përpara datës 1 shtator 2024, marrin masat e nevojshme për të përmbushur kërkesën në lidhje me krijimin e hapësirave të posaçme dhe kushteve të nevojshme për ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me veprimtarinë financiare, në përputhje me kërkesat e pikës 5 të formularit 7 të kësaj rregulloreje, si dhe njoftojnë Bankën e Shqipërisë, brenda datës 31 mars 2025.”;
- j) Në formularin nr. 5 (aneksi i rregullores), pas fjalës “themelues”, shtohet togfjalëshi “/aksioner/ortak”;
- k) Në formularin nr. 6 (aneksi i rregullores), togfjalëshi “Ky dokument është i vlefshëm për 6 muaj”, zëvendësohet kudo me togfjalëshin “Vlefshmëria e këtij dokumenti është pa afat të përcaktuar”, si dhe pas fjalës “themelues”, shtohet togfjalëshi “/aksioner/ortak”.
- l) Në formularin nr. 7 (aneksi i rregullores), pas pikës 4, shtohet pika 5 me përmbajtjen e mëposhtme:  
“5. Informacion mbi hapësira/mjedise të veçanta të nevojshme, si dhe kushte të përshtatshme për evidentimin, mbajtjen, ruajtjen dhe arkivimin e dokumentacionit lidhur me veprimtarinë financiare.”.

2. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes për ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
3. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi në datë 1 shtator 2024.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**BANKA E SHQIPËRISË**  
**KËSHILLI MBIKËQYRËS**

**VENDIM**  
Nr. 43, datë 7.8.2024

**PËR**  
**MIRATIMIN E RREGULLORES**  
**“PËR INFORMACIONIN QË SHOQËRON TRANSFERTAT E FONDEVE”**

Në mbështetje të nenit 1, pika 4, shkronja “b”, nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja “a” dhe nenit 43, shkronja “c” të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 “Për Bankën e Shqipërisë”, i ndryshuar; nenit 9 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 “Për bankat në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; ligjit 55/2020, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”; ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 “Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit”, i ndryshuar; Këshilli Mbikëqyrës i Bankës së Shqipërisë, me propozimin e Departamentit të Mbikëqyrjes,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë rregulloren “Për informacionin që shoqëron transfertat e fondeve”, sipas tekstit bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Ngarkohen ofruesit e shërbimeve të pagesave të përcaktuar në nenin 3, pika 2, shkronjat “a”, “b” dhe “c” të ligjit nr. 55, datë 30.4.2020 “Për shërbimet e pagesave”, për zbatimin e këtij vendimi.
3. Ngarkohet Departamenti i Mbikëqyrjes në Bankën e Shqipërisë me ndjekjen e zbatimit të këtij vendimi.
4. Ngarkohen Kabineti i Guvernatorit dhe Departamenti i Kërkimeve me publikimin e këtij vendimi, përkatësisht në Fletoren Zyrtare të Republikës së Shqipërisë dhe në Buletinin Zyrtar të Bankës së Shqipërisë.

Ky vendim hyn në fuqi 15 ditë pas botimit në Fletoren Zyrtare.

**SEKRETARI**

**ELVIS ÇIBUKU**

**KRYETARI**

**GENT SEJKO**

## **KREU I TË PËRGJITHSHME**

### **Neni 1 Objekti**

Objekti i kësaj rregulloreje është përcaktimi i rregullave për:

- a) informacionin mbi pagesit dhe përfituesit e pagesave që shoqëron transfertat e fondeve, në Euro, në kontekstin e Zonës Unike të Pagesave në Euro (SEPA), pjesëmarrjen e ofruesve të shërbimeve të pagesave në Shqipëri, në skemat e pagesave të administruara nga Këshilli Evropian i Pagesave dhe për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit, në rastet kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave i përfshirë në transfertën e ekzekutuar në një skemë pagese të administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri;
- b) politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese, kur të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri, pavarësisht transaksionit të përfshirë ose monedhës së përdorur.

### **Neni 2 Subjektet**

Subjekte të kësaj rregulloreje janë ofruesit e shërbimeve të pagesave, siç përcaktohen në nenin 3, pika 2, shkronjat "a", "b" dhe "c" të ligjit nr.55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave".

### **Neni 3 Baza ligjore**

Kjo rregullore nxirret në mbështetje të:

- a) nenit 1, pika 4, shkronja "b", nenit 3, pika 3, nenit 12, shkronja "a" dhe nenit 43, shkronja "c" të ligjit nr. 8269, datë 23.12.1997 "Për Bankën e Shqipërisë";
- b) nenit 9 të ligjit nr. 9662, datë 18.12.2006 "Për bankat në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, i cili në këtë rregullore do të quhet ligji "Për bankat";
- c) ligjit nr. 55/2020, datë 30.4.2020 "Për shërbimet e pagesave", i cili në këtë rregullore do të quhet ligji "Për shërbimet e pagesave";
- d) ligjit nr. 9917, datë 19.5.2008 "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", i ndryshuar, i cili në këtë rregullore do të quhet ligji "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".



## Neni 4 Fusha e zbatimit

1. Parashikimet e neneve 7 deri në 14 të kësaj rregulloreje zbatohen për transfertat e fondeve në Euro, të dërguara ose të përfituara, nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të pagesave, të licencuar dhe që operojnë në Shqipëri, si pjesëmarrës në një skemë pagese të administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave, ku të paktën një nga ofruesit e shërbimeve të pagesave ose ofruesit ndërmjetës të shërbimeve të pagesave i përfshirë në transaksion është i vendosur dhe i licencuar në Shqipëri.
2. Parashikimet e neneve 15 deri në 18 të kësaj rregulloreje zbatohen për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar dhe që operojnë në Shqipëri, pavarësisht nga sistemi, skema, transaksioni ose monedha e përdorur.
3. Kjo rregullore zbatohet kur një kartë pagese, një instrument i parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose e teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) me parapagesë ose me kontratë me karakteristika të ngjashme, përdoret për të kryer një transfertë fondesh ndërmjet personave fizikë që veprojnë si konsumatorë jo për qëllime tregtare, të biznesit ose profesionale.

## Neni 5 Përjashtimet nga fusha e zbatimit

Kjo rregullore nuk zbatohet për:

- a) shërbimet e renditura në shkronjat "a" deri në "i" dhe në shkronjën "k" të nenit 4 të ligjit "Për shërbimet e pagesave";
- b) transfertat e fondeve të kryera duke përdorur një kartë pagese, një instrument të parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK) me parapagesë ose me kontratë me karakteristika të ngjashme, në rastet kur plotësohen kushtet e mëposhtme:
  - i. karta, instrumenti ose pajisja është përdorur ekskluzivisht për të paguar për mallra dhe shërbime, dhe
  - ii. numri i kartës, instrumentit ose pajisjes shoqëron të gjitha transfertat që rrjedhin nga transaksioni;
- c) personat që nuk kryejnë aktivitete tjetër përveç konvertimit të dokumenteve në letër në të dhëna elektronike dhe që e bëjnë këtë bazuar në një kontratë me një ofrues të shërbimeve të pagesave, ose për personat që nuk kryejnë asnjë aktivitet tjetër përveç se t'u sigurojnë ofruesve të shërbimeve të pagesave, shërbime të transmetimit të mesazheve ose sisteme të tjera mbështetëse për transmetimin e fondeve ose sisteme të klerimit dhe shlyerjes;
- d) transfertën e fondeve, kur plotësohet ndonjë nga kushtet e mëposhtme:

- i. përfshin tërheqjen e parave fizike nga paguesi nga vetë llogaria e tij e pagesave (paguesit),
  - ii. përbën një transfertë fondesh tek një autoritet publik kombëtar si pagesë për taksat, gjobat ose detyrime të tjera financiare brenda Shqipërisë,
  - iii. si paguesi ashtu edhe përfituesi janë ofrues të shërbimeve të pagesave që veprojnë secili në emër të vet,
  - iv. kryhet përmes shkëmbimeve të imazheve të çeqeve, duke përfshirë çeqet "truncated";
- e) transfertat e fondeve brenda Shqipërisë në llogarinë e pagesave të përfituesit që lejon pagesën ekskluzivisht për ofrimin e mallrave ose shërbimeve kur plotësohen të gjitha kushtet e mëposhtme:
- i. ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit zbaton kërkesat e ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit",
  - ii. ofruesi i shërbimit të pagesave të përfituesit është në gjendje të gjurmojë, nëpërmjet përfituesit, me anë të një kodi unik të identifikimit të transaksionit, transferimin e fondeve nga personi që ka një marrëveshje me përfituesin për ofrimin e mallrave ose shërbimeve,
  - iii. shuma e transfertës së fondeve nuk tejkalon 1,000 euro.

## Neni 6 Përkufizime

1. Termat e përdorur në këtë rregullore kanë të njëjtin kuptim me termat e përdorur në ligjin "Për shërbimet e pagesave", në ligjin "Për bankat" dhe në ligjin "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
2. Përveç sa parashikohet në pikën 1 të këtij neni, për qëllime të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat e mëposhtëm kanë këtë kuptim:
  - a) "financim i terrorizmit" - është financimi i terrorizmit sipas neneve 230/a deri në 230/ç të Kodit Penal;
  - b) "pastrim i parave" - është pastrimi i produkteve të veprës penale të parashikuar në nenin 287 të Kodit Penal;
  - c) "ofrues i shërbimeve të pagesave ndërmjetës" - është një ofrues i shërbimeve të pagesave që nuk është ofrues i shërbimeve të pagesave i paguesit ose i përfituesit dhe që merr dhe transmeton një transfertë fondesh në emër të ofruesit të shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit ose të një ofruesi të shërbimeve të pagesave tjetër ndërmjetës;
  - d) "transfertë e fondeve" - është çdo transaksion i kryer të paktën pjesërisht me mjete elektronike në emër të një paguesi, përmes një ofruesi të shërbimeve të pagesave, me synimin për t'i bërë fondet të disponueshme tek një përfitues, përmes një ofruesi të shërbimeve të pagesave, pavarësisht nëse paguesi dhe përfituesi janë i njëjti person dhe pavarësisht nëse ofruesi i shërbimeve të pagesave të

paguesit dhe ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit janë një dhe i njëjti, duke përfshirë:

- i. një transfertë krediti,
- ii. një debitim direkt,
- iii. një dërgesë parash (remitanca),
- iv. një transfertë të kryer duke përdorur një kartë pagese, një instrument të parasë elektronike, një telefon celular ose çdo pajisje tjetër digjitale ose të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK), me parapagesë ose me kontratë, me karakteristika të ngjashme;
- e) "transfertë në grup" (batch file) - është një bashkësi e disa transfertave të fondeve të grupuara me qëllim transmetimi;
- f) "kod unik i identifikimit të transaksionit" - është një kombinim shkronjash, numrash ose simbolesh, të përcaktuara nga ofruesi i shërbimeve të pagesave, në përputhje me protokollet e sistemeve të pagesave dhe shlyerjeve ose sistemeve të mesazheve të përdorura për transferimin e fondeve, gjë që lejon gjurmimin e transaksionit tek paguesi dhe përfituesi;
- g) "kod i identifikimit të subjektit juridik" (Legal Entity Identifier) - është një kod unik referimi alfanumerik i bazuar në standardin ISO 17442, i caktuar për një person juridik;
- h) "skemë pagese" - është një grup i vetëm rregullash, praktikash, standardesh dhe/ose udhëzimesh zbatimi për të cilat është rënë dakord ndërmjet ofruesit të shërbimeve të pagesave për ekzekutimin e transaksioneve të pagesave brenda Shqipërisë dhe në të gjithë Zonën Unike të Pagesave në Euro (SEPA), dhe që është e ndarë nga çdo infrastrukturë ose sistem pagese që mbështet funksionimin e saj;
- i) "SEPA" - është Zona Unike e Pagesave në Euro (Single Euro Payments Area);
- j) "zona SEPA" - është shtrirja gjeografike e skemave të SEPA-s siç përcaktohet nga kriteret e vendosura nga Këshilli Evropian i Pagesave (KEP);
- k) "skemë pagese SEPA e KEP" - është një skemë pagese e administruar nga Këshilli Evropian i Pagesave (KEP).

## KREU II

### DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE PËR INFORMACIONIN QË SHOQËRON TRANSFERTAT E FONDEVE

#### NËNKREU I

### DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE TË PAGUESIT

#### Neni 7

### Informacioni që shoqëron transfertat e fondeve

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit sigurohet se transfertat e fondeve shoqërohen me informacionin e mëposhtëm për paguesin:
  - a) emri dhe mbiemri i paguesit ose emri i personit juridik të paguesit;
  - b) numri i llogarisë së pagesës së paguesit;
  - c) adresa e paguesit, përfshirë emrin e shtetit apo juridiksionit, numri i dokumentit të identifikimit dhe numri personal i klientit, ose, si alternativë, ditëlindja dhe vendlindja e paguesit; dhe
  - d) kodi i identifikimit të subjektit juridik (në varësi të ekzistencës së fushës së përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës, dhe nëse paguesi ia ka siguruar ofruesit të shërbimeve të pagesave përkatës), ose në mungesë të tij, çdo numër unik identifikimi i barasvlershëm.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit sigurohet që transfertat e fondeve shoqërohen me informacionin e mëposhtëm për përfituesin:
  - a) emri dhe mbiemri i përfituesit ose emri i personit juridik të përfituesit;
  - b) numri i llogarisë së pagesës së përfituesit; dhe
  - c) kodi i identifikimit të subjektit juridik (në varësi të ekzistencës së fushës së përkatëse në formatin e mesazhit të pagesës, dhe nëse paguesi ia ka siguruar ofruesit të shërbimeve të pagesave përkatës), ose në mungesë të tij, çdo numër unik identifikimi i barasvlershëm.
3. Pa rënë ndesh me përcaktimet e pikës 1, shkronja "b", dhe pikës 2, shkronja "b", të këtij neni, në rastin e transfertave që nuk bëhen tek/ose nga një llogari pagesash, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit duhet të sigurojë se transfertat e fondeve shoqërohet me një kod unik të identifikimit të transaksionit, në vend të numrit të llogarisë së pagesës.
4. Përpara transferimit të fondeve, ofruesi i shërbimit të pagesave të paguesit verifikon saktësinë e informacionit të përcaktuar në pikën 1 të këtij neni dhe, ku është e zbatueshme, në pikën 3 të këtij neni, në bazë të dokumenteve, të dhënave ose informacionit të përftuar nga një burim i pavarur dhe i besueshëm.
5. Procesi i verifikimit, i parashikuar në pikën 4 të këtij neni, do të konsiderohet i kryer nëse:
  - a) identiteti i paguesit është verifikuar në përputhje me nenin 4/1 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" dhe informacioni i marrë nga ky verifikim ruhet në përputhje me nenin 16 të atij ligji;
  - b) dispozitat e nenit 4/1 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" zbatohen edhe kur paguesi është klient ekzistues.
6. Pa rënë ndesh me përjashtimet në nenin 8 dhe 9 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk do të ekzekutojë transfertën e fondeve, pa siguruar përputhshmërinë e plotë me parashikimet e këtij neni.

## Neni 8 Transfertat e fondeve brenda Shqipërisë

1. Pa rënë ndesh me përcaktimet në pikat 1 dhe 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, kur të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfshirë në zinxhirin e pagesës janë të vendosur në Shqipëri, transfertat e fondeve shoqërohen të paktën me numrin e llogarisë së pagesës të paguesit dhe numrin e llogarisë së pagesës së përfituesit, ose, kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit, pa cënuar kërkesat për informacion të përcaktuara në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro", kur kjo është e zbatueshme.
2. Pavarësisht nga pika 1 e këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit, brenda 3 ditëve pune pas marrjes së kërkesës për informacion nga ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit ose nga një ofrues i shërbimeve të pagesave ndërmjetës, vë në dispozicion si më poshtë:
  - a) për transfertat e fondeve që tejkalojnë shumën 1,000 euro, pavarësisht nëse këto transferta kryhen si një transaksion i vetëm apo disa transaksione që vlerësohen të lidhura, informacionin mbi paguesin ose përfituesin në përputhje me nenin 7 të kësaj rregulloreje;
  - b) për transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro, që nuk vlerësohen të lidhura me transferta të tjera, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, informacionin që përmban të paktën:
    - i. emrin dhe mbiemrin e paguesit dhe të përfituesit, dhe
    - ii. numrin e llogarisë së pagesës së paguesit dhe të përfituesit, ose, kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit.
3. Pa rënë ndesh me parashikimet në pikën 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në rastin e transfertave të fondeve të përmendura në shkronjën "b" të pikës 2 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin mbi paguesin, përveç se kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit:
  - a) ka marrë fondet që do të transferohen në formën e parasë fizike (cash);
  - b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;
  - c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose
  - d) ka dyshime për mashtrim.

## Neni 9 Transferrat e fondeve jashtë Shqipërisë

1. Në rastin e një transferte në grup (batch file) nga një pagues i vetëm, ku ofruesit e shërbimeve të pagesave të përfituesve janë të vendosur jashtë territorit të Shqipërisë, pika 1 e nenit 7 të kësaj rregulloreje nuk zbatohet për transfertat individuale të grupuara në këtë formë, me kusht që transfertat në grup (batch file) të përmbajë informacionin e përcaktuar në pikat 1, 2 dhe 3 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, dhe ky informacion të jetë verifikuar në përputhje me pikat 4 dhe 5 të nenit 7 të kësaj rregulloreje dhe transfertat individuale të kenë numrin e llogarisë së pagesës të paguesit, ose kur zbatohet pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, të kenë kodin unik të identifikimit të transaksionit.
2. Pa rënë ndesh me parashikimet në pikën 1 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, dhe, aty ku është e zbatueshme, pa rënë ndesh me kërkesat për informacion të përcaktuara në rregulloren "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro", kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit është i vendosur jashtë territorit të Shqipërisë, transfertat e fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro dhe që nuk vlerësohen të lidhura me transfertat të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, shoqërohen me informacionin që përmban të paktën:
  - a) emrin dhe mbiemrin e paguesit dhe të përfituesit, ose emrin e personit juridik të paguesit dhe të përfituesit; dhe
  - b) numrin e llogarisë së pagesës së paguesit dhe të përfituesit, ose, aty ku është e zbatueshme pika 3 e nenit 7 të kësaj rregulloreje, kodin unik të identifikimit të transaksionit.
3. Pa rënë ndesh me parashikimet e pikës 4 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit nuk ka nevojë të verifikojë informacionin mbi paguesin të përmendur në pikën 2 të këtij neni, përveç se kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit:
  - a) ka marrë fondet që do të transferohen në formën e parasë fizike (cash);
  - b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;
  - c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose
  - d) ka dyshime për mashtrim.

## NËNKREU II DETYRIMET E OFRUESIT TË SHËRBIMEVE TË PAGESAVE TË PËRFTUESIT

### Neni 10

#### Zbulimi i informacionit që mungon mbi paguesin ose përftuesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përftuesit zbaton procedura efektive për të zbuluar nëse fushat që lidhen me informacionin mbi paguesin dhe përftuesin në transmetimin e mesazheve, ose në sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve që përdoret për të ekzekutuar transfertën e fondeve, janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranuar në përputhje me rregullat dhe procedurat nga ai sistem.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përftuesit zbaton procedura efektive, përfshirë, aty ku është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të zbuluar nëse mungon informacioni i mëposhtëm mbi paguesin ose përftuesin:
  - a) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i vendosur në Shqipëri, informacioni i parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje;
  - b) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 dhe në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
  - c) për transfertat në grup (batch file), kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 dhe në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në lidhje me atë transfertë në grup (batch file).
3. Në rastin e transfertave të fondeve që tejkalojnë shumën 1,000 euro, pavarësisht nëse këto transfertat kryhen si një transaksion i vetëm ose si disa transaksione që vlerësohen të lidhura, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përftuesit, përpara kreditimit të llogarisë së pagesave të përftuesit ose vendosjes në dispozicion të fondeve për përftuesin, verifikon saktësinë e informacionit mbi përftuesin të përmendur në pikën 2 të këtij neni, bazuar në dokumente, të dhëna apo informacion të marrë nga një burim i pavarur dhe i besueshëm, pa rënë ndesh me kërkesat e përcaktuara në nenet 76 dhe 77 të ligjit "Për shërbimet e pagesave".
4. Në rastin e transfertave të fondeve që nuk tejkalojnë shumën 1,000 euro, që nuk vlerësohen të lidhura me transfertat të tjera fondesh, të cilat, së bashku me transfertën në fjalë, tejkalojnë shumën 1,000 euro, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përftuesit nuk ka nevojë të verifikojë saktësinë e informacionit mbi përftuesin, përveç se në rastet kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përftuesit:

- a) realizon pagesën e fondeve në formën e parasë fizike (cash);
  - b) ka baza të arsyeshme të dyshojë për pastrim parash ose financim terrorizmi;
  - c) ka dyshime për vërtetësinë ose përshtatshmërinë e të dhënave të marra më parë; ose
  - d) ka dyshime për mashtrim.
5. Procesi i verifikimit, i parashikuar në pikat 3 dhe 4 të këtij neni, do të konsiderohet i kryer nëse:
- a) identiteti i përfituesit është verifikuar në përputhje me nenin 4/1 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" dhe informacioni i marrë nga ky verifikim ruhet në përputhje me nenin 16 të atij ligji;
  - b) dispozitat e nenit 4/1 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" zbatohen edhe kur përfituesi është klient ekzistues.

### Neni 11

#### **Transfertat e fondeve me informacion të munguar ose jo të plotë mbi paguesin ose përfituesin**

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit do të zbatojë procedura efektive të bazuara në rrezik, siç parashikohet në nenin 4/1 dhe nenin 11 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", në rastin e një transferte fondesh së cilës i mungon informacioni i plotë i kërkuar mbi paguesin dhe mbi përfituesin, me qëllim që të përcaktojë nëse transfera duhet ekzekutuar, refuzuar ose pezulluar, dhe për të ndërmarrë veprimet e duhura të mëtejshme.
2. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit vihet në dijeni, kur merr një transfertë të fondeve, se informacioni i parashikuar në nenin 7, pika 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", nenin 7, pika 2, shkronjat "a" dhe "b", nenin 8, pika 1, ose në nenin 9, mungon, nuk është i plotë ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme, në përputhje me rregullat dhe procedurat e transmetimit të mesazheve ose të sistemit të pagesave dhe shlyerjeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit:
  - a) kërkon informacionin e nevojshëm për paguesin dhe përfituesin përpara kreditimit të llogarisë së pagesës së përfituesit ose vendosjes së fondeve në dispozicion të përfituesit;
  - b) refuzon transfertën, nëse informacioni i kërkuar sipas shkronjës "a" të kësaj pike nuk plotësohet,

siç parashikohet në nenin 10 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".



3. Në vijim të pikës 2 të këtij neni, ofruesi i shërbimeve të pagesave të përfituesit raporton pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, transfertën e refuzuar për shkak të mossigurimit të informacionit dhe hapat e ndërmarrë, siç parashikohet në nenin 10 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".

### **NËNKREU III**

#### **DETYRIMET PËR OFRUESIN E SHËRBIMEVE TË PAGESAVE NDËRMJETËS**

##### **Neni 12**

#### **Ruajtja e informacionit mbi paguesin dhe përfituesin që shoqëron transfertën**

Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës siguron që i gjithë informacioni i marrë për paguesin dhe përfituesin që shoqëron një transfertë fondesh, ruhet me transfertën.

##### **Neni 13**

#### **Zbulimi i informacionit që mungon mbi paguesin ose përfituesin**

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës zbaton procedura efektive për të zbuluar nëse fushat në lidhje me informacionin mbi paguesin dhe përfituesin në transferimin e mesazheve ose sistemin e pagesave dhe të shlyerjeve të përdorura për të realizuar transfertën e fondeve, janë plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme në përputhje me rregullat dhe procedurat e atij sistemi.
2. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës zbaton procedura efektive, duke përfshirë, kur është e përshtatshme, monitorimin gjatë ose pas transfertave, për të zbuluar nëse mungon informacioni i mëposhtëm për paguesin ose përfituesin:
  - a) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit dhe të përfituesit është i vendosur në Shqipëri, informacioni i parashikuar në nenin 8 të kësaj rregulloreje;
  - b) për transfertat e fondeve, kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 dhe në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje;
  - c) për transfertat në grup (batch file), kur ofruesi i shërbimeve të pagesave të paguesit ose të përfituesit është i vendosur jashtë Shqipërisë, informacioni i parashikuar në shkronjat "a", "b" dhe "c" të pikës 1 dhe në shkronjat "a" dhe "b" të pikës 2 të nenit 7 të kësaj rregulloreje, në lidhje me atë transfertë në grup (batch file).

## Neni 14

### Transfertat e fondeve me informacion të munguar mbi pagesin ose përfituesin

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës harton procedura efektive të bazuara në rrezik për të vendosur nëse do të ekzekutohet, refuzohet ose pezullohet një transfertë fondesh, të cilës i mungojnë informacionet e kërkuara mbi pagesin dhe përfituesin, dhe për marrjen e masave të duhura të mëtejshme.
2. Kur ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës merr dijeni, kur merr një transfertë fondesh, se informacioni i parashikuar në nenin 7, pika 1, shkronjat "a", "b" dhe "c", dhe pikën 2, shkronjat "a" dhe "b" të kësaj rregulloreje, nenin 8, pika 1, ose në nenin 9, mungon ose nuk është plotësuar duke përdorur karaktere ose të dhëna të pranueshme, në përputhje me rregullat dhe procedurat e transmetimit të mesazheve ose sistemit të pagesave dhe shlyerjeve, siç parashikohet në pikën 1 të nenit 10 të kësaj rregulloreje, ai (ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës) mbi bazën e ndjeshmërisë ndaj rrezikut do të:
  - a) kërkojë informacionin e kërkuar për pagesin dhe përfituesin, para ose pas transmetimit të transfertës së fondeve; ose
  - b) refuzojë transfertën.
3. Kur një ofrues i shërbimeve të pagesave, në mënyrë të përsëritur, dështon të japë informacionin e kërkuar për pagesin ose përfituesin, ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës duhet:
  - a) të ndërmarrë hapa, të cilët fillimisht mund të përfshijnë lëshimin e paralajmërimeve dhe caktimin e afateve, përpara se të vazhdohet me refuzimin, kufizimin ose përfundimin në përputhje me shkronjën "b" të kësaj pike, nëse ende nuk ofrohet informacioni i kërkuar; ose
  - b) të refuzojë drejtpërdrejt çdo transfertë të ardhshme të fondeve nga ai ofrues i shërbimeve të pagesave, të kufizojë ose të përfundojë marrëdhënien e tij të biznesit me atë ofrues të shërbimeve të pagesave.
4. Ofruesi i shërbimeve të pagesave ndërmjetës raporton pranë Agjencisë së Inteligjencës Financiare, transfertën e refuzuar për shkak të mossigurimit të informacionit dhe hapat e ndërmarrë.

## KREU III

### ZBATIMI I MASAVE SHTRËNGUESE

## Neni 15

### Politikat, procedurat dhe kontrollet e brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese

1. Ofruesi i shërbimeve të pagesave duhet të ketë politika, procedura dhe kontrolle të brendshme për të siguruar zbatimin e masave shtrënguese sipas ligjit nr. 72/2019 "Për masat shtrënguese ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë", gjatë kryerjes së transfertave të fondeve sipas kësaj rregulloreje ose dispozitave të tjera në fuqi.

## **KREU IV**

### **INFORMACIONI, MBROJTJA DHE RUAJTJA E TË DHËNAVE**

#### **Neni 16**

##### **Sigurimi i informacionit**

Ofruesi i shërbimeve të pagesave do të përgjigjet plotësisht dhe pa vonesë, në përputhje me kërkesat ligjore dhe rregullative përkatëse, për kërkesat përkatëse nga Banka e Shqipërisë ose Agjencia e Inteligjencës Financiare, në lidhje me informacionin e përcaktuar sipas kësaj rregulloreje.

#### **Neni 17**

##### **Mbrojtja e të dhënave**

1. Ofruesit e shërbimeve të pagesave sigurojnë që përpunimi i të dhënave personale sipas kësaj rregulloreje, i nënshtrohet legjislacionit në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij.
2. Të dhënat personale do të përpunohen në bazë të kësaj rregulloreje vetëm për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit dhe nuk do të përpunohen më tej në një mënyrë të papajtueshme me ato qëllime. Përpunimi i të dhënave personale në bazë të kësaj rregulloreje për qëllime tregtare është rreptësisht i ndaluar.
3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave do t'u ofrojnë klientëve të rinj informacionin e kërkuar në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale, përpara se të krijojnë një marrëdhënie biznesi ose të kryejnë një transaksion të rastit. Ky informacion do të jepet në një formë koncize, transparente, të kuptueshme dhe lehtësisht të aksesueshme, në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave personale dhe, në veçanti, do të përfshijë një njoftim të përgjithshëm në lidhje me detyrimet ligjore të ofruesit të shërbimeve të pagesave sipas kësaj rregulloreje, kur përpunon të dhëna personale për qëllime të parandalimit të pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit.

4. Ofruesit e shërbimeve të pagesave duhet të sigurojnë gjithmonë që transmetimi i çdo të dhëne personale për palët e përfshira në transfertën e fondeve, të kryhet në përputhje me legjislacionin në fuqi për mbrojtjen e të dhënave.

### **Neni 18** **Ruajtja e të dhënave**

1. Informacioni mbi paguesin dhe përfituesin nuk do të ruhet për më gjatë se sa është e nevojshme. Ofruesit e shërbimeve të pagesave të paguesit dhe të përfituesit do të ruajnë regjistrat e informacionit të parashikuar në nenet 7 deri në 10 të kësaj rregulloreje, në përputhje me afatet e përcaktuara në nenin 16 të ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit".
2. Në përfundim të skadimit të periudhës së ruajtjes së të dhënave të parashikuar në pikën 1 të këtij neni, ofruesit e shërbimeve të pagesave do të sigurojnë që të dhënat personale të fshihen, me përjashtim të rasteve kur parashikohet ndryshe në ligj.
3. Agjencia e Inteligjencës Financiare mund të lejojë ose të kërkojë ruajtjen e të dhënave për një periudhë më të zgjatur, për një periudhë maksimale prej pesë vjetësh, pasi të ketë kryer një vlerësim të plotë të domosdoshmërisë dhe proporcionalitetit të ruajtjes për një periudhë më të zgjatur dhe kur e konsideron të justifikuar si të nevojshme për parandalimin, zbulimin ose hetimin e pastrimit të parave ose financimit të terrorizmit.

## **KREU V** **TË TJERA**

### **Neni 19** **Aktet e tjera në fuqi**

1. Kjo rregullore do të interpretohet dhe zbatohet në përputhje me dispozitat e ligjit "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit", dhe ky i fundit do të mbizotërojë në rast të ndonjë konflikti. Zbatimi i masave të shtuara, detyrimet e raportimit ose çdo detyrim i lidhur do të ketë përparësi, në rast dyshimi për pastrim parash ose financim terrorizmi.
2. Dispozitat e rregullores "Për parandalimin e pastrimit të parave dhe financimit të terrorizmit" zbatohen për çdo rast që nuk parashikohet shprehimisht në këtë rregullore.

## Neni 20 Raportimi i shkeljeve

Ofruesit e shërbimeve të pagesave hartojnë procedura të brendshme të përshtatshme për punonjësit e tyre të të gjitha niveleve, për të raportuar shkeljet e kësaj rregulloreje brenda subjektit, nëpërmjet një sistemi të sigurt, të pavarur, specifik dhe anonim, në përpjesëtim me natyrën dhe madhësinë e subjektit në fjalë.

## Neni 21 Hyrja në fuqi

2. Kjo rregullore hyn në fuqi pas miratimit të zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA në Republikën e Shqipërisë, nga Këshilli Evropian i Pagesave.
3. Ofruesit e shërbimeve të pagesave që janë objekt i kësaj rregulloreje marrin masat e nevojshme për përshtatjen e aktiviteteve dhe operacioneve të tyre me kërkesat e kësaj rregulloreje, brenda një periudhe prej 180 ditësh nga miratimi i zgjerimit të shtrirjes gjeografike të SEPA-s në Shqipëri, nga Këshilli Evropian i Pagesave.

**KRYETARI I KËSHILLIT MBIKËQYRËS**

**GENT SEJKO**

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 1,  
JANAR 2024**

1. Licencë nr. 55, datë 3.11.2023, "Për të vepruar si institucion i parasë elektronike në Republikën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 2, datë 24.1.2024, për miratimin e rregullores "Për organizimin dhe funksionimin e Komitetit për Sistemet e Pagesave"
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 3, datë 24.1.2024, "Për miratimin e disa ndryshimeve në kontratën tip për riblerjen e titujve"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 5, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë "Për krijimin e monedhave pa kurs ligjor, përkujtimore dhe për qëllime numizmatike për 2024-2029""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 6, datë 24.1.2024 "Për miratimin e Strategjisë të Bankës së Shqipërisë për edukimin dhe përfshirjen financiare, 2024-2026"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 7, datë 24.1.2024 "Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së bashkëpunimit midis Bankës së Shqipërisë dhe Akademisë së Sigurisë"

**TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 2,  
SHKURT 2024**

1. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. 644, datë 6.2.2024 "Për pezullimin e licencës së subjektit financiar jobankë "Micro Credit Albania""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 9, datë 7.2.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.10, datë 7.2.2024, "Për miratimin e udhëzimit "Për raportimin e incidenteve madhore"
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr.11, datë 7.2.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për përcaktimin e nivelit të vendimmarrjes në mbikëqyrjen e veprimtarive bankare dhe financiare""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 12, datë 7.2.2024, "Për miratimin e rregullores "Për procedurat e krijimit dhe shtypjes së monedhave dhe kartëmonedhave pa kurs ligjor, përkujtimore për qëllime numizmatike, dhe medaljoneve përkujtimore nga Banka e Shqipërisë""

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 3, PRILL 2024

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 15, datë 6.3.2024 "Për një ndryshim në rregulloren "Për raportin e mjaftueshmërisë së kapitalit""
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 16, datë 6.3.2024 "Për shtypjen e monedhës metalike përkujtime, për qëllime numizmatike, me tematikë "100 vjet Banka e Shqipërisë, 1925-2025""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 17, datë 20.3.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë".
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 18, datë 20.3.2024 "Për miratimin e pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë për vitin 2023"
5. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr. prot. 1481, datë 2.4.2024 "Për caktimin e shtesave makroprudenciale të kapitalit"
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 21, datë 3.4.2024 "Për miratimin e rregullores "Për përcaktimin e kërkesave për transfertat e kreditit dhe të debitimit direkt në Euro""
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 24, datë 3.4.2024 "Për rishtypjen e kartëmonedhës shqiptare me kurs ligjor, me prerje 200 Lekë dhe 500 Lekë"

## TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 4, QERSHOR 2024

1. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 26, datë 8.5.2024 "Për mbajtjen e pandryshuar të normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë"
2. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 27, datë 8.5.2024 "Për "Një ndryshim në vendimin nr. 36, datë 25.6.2014 të Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë për miratimin e procedurës së veçantë të prokurimit për përzgjedhjen e audituesit të jashtëm të pasqyrave financiare të Bankës së Shqipërisë dhe të fondit të pensionit suplementar", i ndryshuar""
3. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 28, datë 8.5.2024 "Për miratimin e "Dokumentit të politikës së investimit të fondit të pensionit në Bankën e Shqipërisë""
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 29, datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për krahasueshmërinë e tarifave të lidhura me llogaritë e pagesave dhe për shërbimin e transferimit të llogarive të pagesave""
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 30 datë 8.5.2024 "Për disa ndryshime në rregulloren "Për sigurinë e informacionit""
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 31, datë 8.5.2024 "Për një ndryshim në vendimin e Këshillit Mbikëqyrës nr. 17, datë 23.3.2023

- “Për miratimin e konfigurimeve të vizatimeve të monedhës përkujtimore, që do të shtypet për qëllime numizmatike në vitin 2023””
7. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2302, datë 23.5.2024 “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Micro Credit Albania” SH.P.K.”
  8. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2303, datë 23.5.2024 “Për revokimin e licencës së subjektit financiar jobankë “Final” SH.P.K.”
  9. Urdhër i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2454, datë 4.6.2024 “Për hedhjen në qarkullim të monedhave metalike shqiptare, me kurs ligjor, me vlerë nominale 5 Lekë”
  10. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 32, datë 5.6.2024 “Për miratimin e liritimit nga detyra të drejtorit të Departamentit për Ndërhyrjen e Jashtëzakonshme të Bankës së Shqipërisë”
  11. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 33, datë 5.6.2024 “Për disa shtesa dhe ndryshime në rregulloren “Për licencimin dhe ushtrimin e veprimtarisë nga subjektet financiare jobanka””

#### **TREGUESI I LËNDËS PËR BULETININ ZYRTAR, VËLLIMI 26, NUMËR 5, KORRIK 2024**

1. Vendim i Zëvendësguvernatorit i dytë të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 5427, datë 28.12.2023 Për miratimin e politikës së administrimit të mjeteve financiare të fondit të ndërhyrjes së jashtëzakonshme”
2. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2819, datë 27.6.2024”
3. Vendim i Guvernatorit të Bankës së Shqipërisë, nr.prot. 2820, datë 27.6.2024”
4. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 34, datë 3.7.2024 “Për uljen e normës së interesit të marrëveshjeve të riblerjes dhe të anasjella të riblerjes dhe të normave të interesit të depozitës njëditore dhe të kredisë njëditore në Bankën e Shqipërisë”
5. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 35, datë 3.7.2024 “Për miratimin e disa ndryshimeve në rregulloren “Për politikën dhe mënyrën e administrimit të arit””
6. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 36, datë 3.7.2024 “Për miratimin e një ndryshimi në rregulloren “Për funksionimin e sistemit qendror të regjistrimit dhe shlyerjes së titujve (afisar)””
7. Vendim i Këshillit Mbikëqyrës të Bankës së Shqipërisë, nr. 39, datë 3.7.2024 “Për miratimin e delegimit të kompetencës për nënshkrimin e marrëveshjes së konfidencialitetit midis bankave qendrore në kuadër të pjesëmarrjes në projektin dctf-ii (the data collection task force-ii) të rrjetit “Historia monetare e Evropës juglindore (south-eastern european monetary history network - seemhn)”